



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD

RELACION TEKNIK

PËR HARTIMIN E PROJEKTIT DHE ZBATIMIN E PUNIMEVE:


**OBJEKTI: “RIKONSTRUKSION,ZGJERIM DHE RIKUALIFIKIM
I SHKOLLËS SË MESME “IBRAHIM MUÇA”,LIBRAZHD ME
AMBIENTE TE REJA EDUKATIVE,DIDAKTIKE,SPORTIVE DHE
PËRMIRËSIM TË EFICENCËS ENERGJITIKE.”**

VENDI I NDERTIMIT: Ruga “Jakup Bëçaku”, Librazhd

PËRMBAJTJA

1. GJENDJA EKZISTUESE DHE POZICIONI FAKTIK	3
2. QELLIMI.....	8
3. DOKUMENTACIONI.....	8
4. NDËRHYRJET E PARASHIKUARA.....	8

- **GJENDJA EKZISTUESE DHE POZICIONI FAKTIT**



Shkolla e Mesme "Tbrahim Muça", ndodhet në qytetin e Librazhdit, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan. Shkolla është e pozicionuar përgjatë Rrugës "Jakup Biçaku", në një zonë me karakter kryesisht arsimor dhe administrativ, brenda territorit urban të qytetit.

Terreni në zonën e studimit është kryesisht i sheshtë, me pjerrësi të vogël natyrore, gjë që favorizon aksesin dhe funksionimin e objektit. Vendndodhja e gjimnazit siguron lidhje të mirë me infrastrukturën rrugore, institucionet publike, zonat sportive dhe blloqet e banimit përreth, duke e bërë atë një nga institucionet kryesore arsimore të qytetit të Librazhdit.

Nga inspektimi teknik dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të Gjinnazit "Ibrahim Muça", në qytetin e Librazhdit, konstatohet se objekti paraqet një shkallë të konsiderueshme amortizimi, si pasojë e vjetërsisë së ndërtesës, përdorimit të vazhdueshëm ndër vite, si dhe mungesës së ndërhyrjeve të plota rikonstruktuese dhe rehabilituese. Si rrjedhojë, një pjesë e elementeve konstruktive, arkitektonike dhe e elementeve të përfundimit të objektit (si suvatimet, veshjet, dyshemetë, tavanet, dyert dhe dritaret) shfaqin shenja degradimi fizik, konsumimi të materialeve dhe ulje të performancës funksionale, duke mos përmbushur në mënyrë të plotë kërkesat teknike dhe standardet bashkëkohore të projektimit dhe funksionimit të institucioneve arsimore.

Nga verifikimet në terren konstatohet gjithashtu se në objekt është realizuar, në një periudhë të mëvonshme, një shtesë ndërtimore e lidhur me godinën ekzistuese. Në zonën e bashkimit ndërmjet dy strukturave evidentohen plasaritje të dukshme në mure dhe në elementet e dysHEMEVE, të cilat tregojnë praninë e deformimeve relative ose të lëvizjeve diferenciale ndërmjet pjesës ekzistuese dhe shtesës. Ky fenomen mund të lidhet me diferenca në sjelljen strukturore të dy trupave ndërtimorë, ulje diferenciale të themeleve, ndryshime në skemën mbajtëse ose me mungesën e trajtimit të përshtatshëm të nyjes së lidhjes gjatë fazës së ndërtimit.


Në kuadër të projektit të rikonstruksionit rekomandohet kryerja e një vlerësimi të detajuar strukturor të kësaj zone, me qëllim identifikimin e shkaktit të fenomenit dhe projektimin e masave të nevojshme për rehabilitimin e tij. Në varësi të rezultateve të ekspertizës teknike, ndërhyrjet mund të përfshijnë riparimin dhe përforcimin lokal të elementeve të dëmtuara, trajtimin e nyjes së lidhjes ndërmjet dy strukturave, si dhe, nëse rezulton e nevojshme, krijimin e një nyje sizmike (dilatacioni) ose zgjidhje të tjera inxhinierike që garantojnë funksionimin e sigurt dhe afatgjatë të objektit.

Nga analiza funksionale rezulton se organizimi aktual i ambienteve nuk i përgjigjet nevojave të procesit mësimor bashkëkohor. Hapësirat ekzistuese mësimore janë të kufizuara në kapacitet dhe fleksibilitet, ndërsa mungojnë ose janë të pamjaftueshme ambientet multifunkionale, laboratorët e specializuar, hapësirat për punë në grup, mjediset e studimit, si dhe ambientet mbështetëse të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve edukative, kulturore dhe jashtëshkollore.

Në këto kushte, vlerësohet e domosdoshme ndërhyrja për rikonstruksionin e plotë të objektit, me synim përmirësimin e parametrave konstruktivë, teknikë, funksionalë, energjetikë dhe arkitektonikë, si dhe rritjen e nivelit të sigurisë, aksesueshmërisë dhe komoditetit për përdoruesit. Paralelisht me rikonstruksionin, rekomandohet zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese nëpërmjet krijimit të hapësirave të reja didaktike dhe multifunkionale, të projektuara në përputhje me standardet aktuale për infrastrukturën arsimore. Këto ndërhyrje do të mundësojnë aplikimin e metodologjive moderne të mësimdhënies, përmirësimin e cilësisë së procesit edukativ dhe përmbushjen në mënyrë më efektive të nevojave të komunitetit shkollor, duke garantuar një mjedis mësimor bashkëkohor, funksional dhe gjithëpërfshirës.

Për të garantuar funksionimin e sigurt, efikas dhe në përputhje me standardet bashkëkohore të infrastrukturës arsimore, vlerësohet i domosdoshëm rikonstruksioni i plotë i objektit. Në kuadër të këtij investimi parashikohet realizimi i ndërhyrjeve të mëposhtme:




- Punime civile, duke përfshirë ndërhyrjet arkitektonike, konstruktive, punimet e rifiniturës, si dhe rehabilitimin ose zëvendësimin e instalimeve hidrosanitare, mekanike, elektrike dhe sistemeve të tjera teknike të ndërtesës.
- Furnizimin dhe instalimin e pajisjeve hidrosanitare, aksesorëve dhe elementeve të tjerë përbërës të sistemeve teknike, të nevojshëm për vënien në funksion dhe operimin normal të objektit.
- Rikonstruksioni duhet të mundësojë funksionimin normal duke optimizuar shfrytëzimin e kapaciteteve dhe përmbushjen e standarteve teknike.



Gjendja ekzistuese e ambienteve ku parashikohen ndërhyrjet paraqitet si më poshtë:

- Ambientet e brendshme dhe të jashtme të objektit paraqesin shkallë të konsiderueshme amortizimi dhe degradimi si pasojë e vjetërsisë dhe përdorimit të vazhdueshëm ndër vite.
- Në zonën e bashkimit ndërmjet godinës ekzistuese dhe shtesës së realizuar në një fazë të mëvonshme evidentohen plasaritje në mure dhe në elementet e dysHEMEVE, të cilat tregojnë një sjellje të diferencuar ndërmjet dy strukturave dhe kërkojnë vlerësim të detajuar strukturor.
- Objekti nuk është i pajisur me sistem të mbrojtjes nga zjarri në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe standardeve teknike në fuqi.
- Rrjetet e instalimeve elektrike dhe hidrosanitare janë të amortizuara dhe nuk përmbushin kërkesat teknike, funksionale dhe të sigurisë për një institucion arsimor.
- Sistemi ekzistues i ngrohjes është i vjetëruar dhe bazohet kryesisht në soba me dru ose kaloriferë elektrikë, duke mos garantuar kushte të përshtatshme të komfortit termik gjatë sezonit të dimrit. Gjithashtu, objekti nuk disponon sistem kondicionimi për ftohjen e ambienteve mësimore, administrative dhe ndihmëse (drejtoria, zëvendësdrejtoria, sekretaria, salla e mësuesve, biblioteka etj.), çka ndikon negativisht në kushtet e punës dhe zhvillimin normal të procesit mësimor gjatë periudhës me temperatura të larta.
- Sistemi ekzistues i hidroizolimit ka humbur funksionalitetin e tij, duke shkaktuar depërtim të lagështisë dhe dëmtime në elementet e ndërtimit.
- Dyert dhe dritaret ekzistuese janë të amortizuara dhe me performancë të ulët termoizoluese, duke mos përmbushur kërkesat aktuale të efikasitetit energjetik dhe duke shkaktuar humbje të konsiderueshme të energjisë.
- Ambientet sanitare janë në gjendje të amortizuar dhe kapaciteti i tyre është i pamjaftueshëm për numrin aktual të përdoruesve, duke bërë të nevojshëm rehabilitimin dhe zgjerimin e tyre.
- Organizimi funksional i godinës nuk i përgjigjet kërkesave bashkëkohore të procesit mësimor. Evidentohen ambiente të pashfrytëzuara, ndërkohë që mungojnë kabinete mësimore, laboratorë të specializuar, hapësira multifunksionale, ambiente studimi, si dhe hapësira rekreative dhe kulturore për zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe jashtëshkollore.
- Objekti nuk garanton aksesueshmëri të plotë për personat me aftësi të kufizuara (PAK), në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe standardeve në fuqi.
- Suvatimet e brendshme dhe të jashtme paraqesin degradime, plasaritje dhe dëmtime të ndryshme si pasojë e konsumimit ndër vite dhe veprimit të faktorëve atmosferikë.
- Dyshemetë e ambienteve të brendshme janë të shtruara me pllaka të amortizuara, me dëmtime dhe konsumim të konsiderueshëm.
- Muri rrethues i territorit të shkollës paraqet degradime të dukshme dhe nuk garanton nivelin e kërkuar të sigurisë dhe funksionalitetit.
- Hapësirat e jashtme të shkollës janë të pasistemuara dhe nuk plotësojnë kushtet funksionale për zhvillimin e aktiviteteve mësimore, sportive dhe rekreative.





- QELLIMI

Duke synuar optimizimin e performances tekniko-financiare dhe eficenses energjitike ne funksion te nevojave dhe kriterëve te shfrytezimit, qellimet kryesore qe do te realizoje kjo kontrate jane:

- Kontrolli dhe evidentimi i gjendjes aktuale te ambienteve ne kete objekt.
- Hartimin e projektit arkitektonik (perfshire mobilimin e ambjenteve) duke synuar optimizimin e shfrytezimit te hapësirave.
- Hartimin e projektit konstruktiv, duke perfshire nderhyrjet strukturale, refiniturave etj.
- Hartimin e projektit hidrosanitar dhe sistemit te ngrohje-ftohjes.
- Hartimin e projektit elektrik.
- Hartimin e projektit te plote te mbrojtjes nga zjarri (sistemit MKZ antizjarr).

Konkretisht, ndërhyrjet e parashikuara synojnë:

- Përmirësimin e kushteve për zhvillimin e procesit mësimor dhe rritjen e cilësisë së shërbimit arsimor.
- Rritjen e funksionalitetit, efikasitetit dhe sigurisë së objektit, në përputhje me standardet bashkëkohore të infrastrukturës arsimore.
- Përmirësimin e performancës teknike, arkitektonike dhe energjetike të ndërtesës.
- Riorganizimin dhe optimizimin funksional të ambienteve të brendshme dhe të jashtme, duke krijuar hapësira të përshtatshme për procesin mësimor, aktivitetet kulturore, sportive dhe rekreative.
- Përmirësimin e cilësisë estetike dhe të identitetit arkitektonik të Gjimnazit "Ibrahim Muça", nëpërmjet zgjidhjeve projektuese bashkëkohore, funksionale dhe të harmonizuara me karakterin e institucionit.

- DOKUMENTACIONI

Ne perfundim te projektit jane hartuar perkatesisht:

- Pergatitja e Projektit te Plote te Zbatimit
- Vizatime te Projektit dhe Specifikimet Teknike
- Preventivi i Punimeve
- Relacioni Teknik
- Metodologjia e Nderhyrjes
- Grafiku i punimeve
- **NDERHYRJET E PARASHIKUARA**

Të gjitha ndërhyrjet e parashikuara në kuadër të hartimit të projektit për rikonstruksionin e Gjimnazit " Ibrahim Muça " në Bashkinë "Librazhd" janë përcaktuar mbi bazën e analizës së gjendjes ekzistuese të objektit. Për këtë qëllim është kryer një inspektim i detajuar në terren nga ekipi i projektimit, i përbërë nga inxhinierë dhe arkitektë, gjatë të cilit janë evidentuar problematikat konstruktive, arkitektonike, funksionale dhe ato të instalimeve teknike.

Në kuadër të projektit të rikonstruksionit parashikohen ndërhyrjet e mëposhtme:

- Riorganizimi funksional i ambienteve të brendshme, me krijimin e kabineteve mësimore, laboratorëve, zgjerimin e bibliotekës, riorganizimin e sallës së mësuesve dhe optimizimin e ambienteve administrative e ndihmëse.
- Ndërtimi i një godine të re në pjesën hyrëse të kompleksit shkollor, e projektuar si auditor multifunksional për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, artistike dhe edukative.
- Rehabilitimi i zonës së bashkimit ndërmjet godinës ekzistuese dhe shtesës së realizuar në një fazë të mëvonshme, duke përfshirë trajtimin e plasaritjeve dhe realizimin e nyjes sizmike (fugës sizmike), sipas projektit konstruktiv.
- Ndërtimi i një kopshti didaktik mësimor në tarracën e godinës së re, të pajisur me serë eksperimentale, shtretër kultivimi, sistem ujitjeje dhe substrat vegjetativ, për zhvillimin e aktiviteteve praktike dhe edukative.
- Ndërtimi i një fushe kalçetoje me bar artificial, të pajisur me stola për spektatorët dhe elementët ndihmës për zhvillimin e aktiviteteve sportive.
- Shtimi dhe riorganizimi i nyjeve sanitare në çdo kat, duke përfshirë edhe ambientet sanitare të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.
- Sigurimi i aksesueshmërisë së plotë të objektit për personat me aftësi të kufizuara (PAK), në përputhje me legjislacionin dhe standardet në fuqi.
- Zëvendësimi i shtresave dhe nënshtresave të dysHEMEVE, me korrigjimin e kuotave sipas nevojës dhe përdorimin e materialeve të lehta aty ku kërkohet.
- Shtrimi i të gjitha ambienteve të brendshme me pllaka porcelani gres.
- Zëvendësimi i dritareve ekzistuese me dritare PVC (duroplast) me dopio xham termoizolues.
- Zëvendësimi i davancaleve ekzistuese.
- Zëvendësimi i dyerve të brendshme sipas projektit arkitektonik.
- Rehabilitimi i suvatimeve të brendshme dhe të jashtme.
- Lyerja e të gjitha ambienteve të brendshme dhe të jashtme me bojë ekologjike të cilësisë së parë.
- Rehabilitimi i sistemit të hidroizolimit të tarracës dhe i zonave ku evidentohen infiltrime të ujit.
- Vendosja e sistemit të ri të ulluqeve horizontale dhe vertikale për largimin e ujërave atmosferike.
- Zëvendësimi i plotë i instalimeve hidrosanitare dhe i pajisjeve hidrosanitare.
- Zëvendësimi i plotë i instalimeve elektrike dhe realizimi i sistemit të ri të ndriçimit me teknologji LED me efikasitet të lartë energjetik.
- Instalimi i sistemit HVAC për ngrohje, ventilm dhe kondicionim të ambienteve, në integrim me sistemin e ftohtësisë me gaz.
- Instalimi i impiantit fotovoltaiik për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.
- Instalimi i sistemit të automatizimit, monitorimit dhe menaxhimit të instalimeve teknologjike të objektit, për kontrollin dhe optimizimin e funksionimit të sistemeve mekanike, elektrike dhe energjetike, si dhe për monitorimin e konsumit të energjisë.
- Realizimi i sistemit të mbrojtjes nga zjarri, në përputhje me projektin dhe standardet teknike në fuqi.
- Realizimi i rrjetit të strukturuar të komunikimit (LAN) dhe infrastrukturës së telekomunikacionit.
- Instalimi i sistemit të monitorimit me kamera (CCTV).

- Instalimi i sistemit të kontrollit të aksesit në ambientet e përcaktuara nga projekti.
- Realizimi i sistemit të sinjalizimit dhe alarmit, sipas kërkesave të projektit dhe standardeve teknike në fuqi.
- Sistemimi i plotë i ambienteve të jashtme dhe i infrastrukturës së oborrit.
- Rikonstruksioni ose ndërtimi i ri i murit rrethues të kompleksit shkollor.
- Shtrimi i oborrit dhe i rrugicave të brendshme me pllaka trotuari.
- Realizimi i ndriçimit të jashtëm të oborrit, shtigjeve të lëvizjes, hapësirave rekreative dhe fushës sportive.
- Krijimi i hapësirave të gjelbra, forumeve dhe zonave rekreative.
- Vendorsja e sinjalistikës orientuese, informuese dhe të sigurisë në të gjithë kompleksin shkollor.

PUNOI:

“STATENG” sh.p.k.

Administrator

Ing. ERION LAMI